

Përfaqësuesja / Rama: Kam pritur një lojë më të mirë

nga Yll Begu

E hënë, 28 Mars 2011 12:55



Sulmuesi i Orebros, Valdet Rama, deklaroi se loja në miqësoren kundër Renovës nuk ka qenë e mirë për kundër angazhimit të madh të futbollistëve. “Nuk kam parashikuar se kjo miqësore do të mbyllej pa gola. Më vjen keq që tifozët nuk patën rast të shohin një lojë më të mirë, por këtu ndikoi fusha. Gjatë stërvitjeve e kemi planifikuar krejt ndryshe këtë lojë, me pasime dhe lojë të shpejtë, por kjo fushë nuk na lejojë t’i lidhim as dy-tri pasime ndërmjet veti”, tha Rama.